

AKT THEMELIMI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR " COTRA ALBANIA "

Në Durrës, sot në datën 18/ 04/2018( Tetëmbëdhjetë/ Prill/ Dymijë e tetëmbëdhjetë ), unë :

**Antonio Careri**, atesia Paolo, i datëlindjes 30/10/1947, lindur në Cento ( FE ), dhe banues : Rruga " Camillo Cavour ", 34/A, 28043, Bellinzago Novarese Italia, pajisur me Pasaportë italiane Nr. YA8557818, lëshuar në datën 19/02/2016, shtetas italian, madhor, me zotësi juridike dhe zotësi të plotë për të vepruar.

Bazuar në Ligjin Nr. 9901, datë 14/04/2008 " Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare " ( i azhurnuar ), Ligjin Nr. 9723, datë 03/05/2007 " Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit "... etj.

Themeloh shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar të emërtuar " COTRA ALBANIA " sh.p.k.

Selia e shoqërisë është në Durrës, në adresën : Lajja Nr. 3, Sheshi " Liria ", Qendra e Biznesit " Best Co " .

Objekti i shoqërisë është : " Tregti, import dhe eksport, investime në energjistikë, projektim, investime në hekurudha, investime detare, logjistikë detare/ tokësore dhe ajrore " .

Kohëzgjatja e ushtrimit të aktivitetit të Shoqërisë është pa afat.

Kapitali themeltar i shoqërisë është 1'500'0000 ( Një milionë e pesëqind mijë ) Lekë, i përbërë nga 1 kuotë me vlerë nominale 1'500'000 ( Një milionë e pesëqind mijë ) Lekë dhe zotërohet nga unë ortakut themelues Antonio Careri.

Shoqëria do të shtrijë aktivitetin e saj tregtar në të gjithë juridiksionin territorial të Republikës së Shqipërisë. Me Vendim të Asamblesë së përgjithshme mund të ndryshohet, krijohet ose anulohet ( në rast se janë çelur ) Seli, Filiale, Agjenci dhe perfaqësi në qytete të tjera të Republikës së Shqipërisë.

Administrimi i shoqërisë

**Administrator i shoqërisë emërohet Z. Antonio Careri**, i cili deklaron se pranon rolin e ngarkuar dhe se nuk ekzistojnë shkaqe të ligjshme që mund ta shpallin të pavlefshme.

**Afati i emërimit të administratorit është pesë vjet.** Administratori emërohet sot në datën 18/04/2018 dhe përfundon në datën 18/ 04/ 2023. Emërimi i prodhon efektet pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit ( Neni 95, pika e parë e Ligjit Nr. 9901, date 14/04/2008 Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare )

Administratori përfaqëson shoqërinë tregtare, kryen veprimtarinë tregtare të shoqërisë duke zbatuar politika tregtare të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme.

Në rastet e kryerjes së veprimtarive të rëndësishme që kanë të bëjnë me shpenzime në vlera të mëdha dhe që lidhen me transakcione të pasurive të paluajtshme, shkëmbime apo çdo lloj tjetërsimi të tyre, zmadhime të kapitalit themeltar, venie garancie hipotekore apo bankare, marrje kredie, marrje pjesë në tendera brenda vendit apo ndërkombetare, Administratori i Përgjithshëm i emëruar kryen veprime bankare vetëm mbi bazën e Vendimit me shkrim të Mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, i cili duhet të jetë legalizuar nga Noteri.


*RA*

Ortakërisë mbi bazën e vendimit të Asamblesë së Përgjithshme dhe sipas procedurave që janë përcaktuar në Statutin e shoqërisë.

Ky Akt Themelimi redaktohet në tre njësi origjinale, me nga dy faqe secila, në gjuhën shqipe, me përmbajtje e vlera të njëjta juridike dhe pasi lexohet me zë miratohet nga ortakut themelues dhe nënshkruhet prej tij në çdo faqe.

ORTAKU I VETËM THEMELUES

I " COTRA ALBANIA " SH.P.K

  
\_\_\_\_\_  
*RA*